

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Turisti argëton veten, ne nuk kemi çfarë t'i ofrojmë" – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/turisti-argeton-veten-ne-nuk-kemi-cfare-ti-ofrojme/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:57:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:52:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fcbf101b02e3adbb68f5a52f5073f52f3ac0c509c293a2ea006e4a9edd94e109
TEKSTI	4c7652a32d0e525455f7345ca048d1a2efc16e35dc808df5ad1a70f2d34837c3
PAMJA	05164b21a8dbdc02e39feedf96ddf3ee160b6c898eca5d99781b37484ca6f335

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	df84e4957ba6326b5cc617d60f25a0c911a9f195f3916013757112bd11edcc8c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	67690963e34eac89a6c1ba46d066d36b47b728dbf8bf8d029d400ef1ab927ee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/df84e4957ba6326b5cc617d60f25a0c911a9f195f3916013757112bd11edcc8c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



"Në përgjithësi, sezoni ka qenë i mbarë dhe me shifra në rritje, por vulën do ta vërë Banka e Shqipërisë me shpenzimet që kanë kryer turistët përgjatë gjithë vitit. Nëse shifra do të kalojë mbi 5.5 miliardë lekë, atëherë mund të themi se ishte i suksesshëm. Por e veçanta e këtij sezoni ishte fakti se pati një rritje të numrit të turistëve në apartamentet me qira. Edhe këtë vit, raporti çmim-cilësi vijon të sfidojë turizmin vendas" – pohoi Rraman Kasa nga Unioni Turistik.

Refreni që nuk ndryshon asnjë vit mbetet problemi me trafikun, rrugët, parkimet, transportin publik dhe infrastrukturën në destinacionet turistike.

"Ka site turistike që nuk vizitohen sepse nuk ka rrugë. Pastërtia vijon të jetë një shqetësim permanent. Ka përmirësime, por sërish është problem i pazgjidhur që ndikon negativisht në imazhin e vendit", – thotë Shkëlqim Lamaj.

Sipas biznesit, protestat qytetare gjatë sezonit nuk duket se patën një ndikim të madh në flukset turistike. Por sfida më e madhe mbetet argëtimi i turistëve. Mungesa e eventeve të mëdha dhe e një kalendarit të qëndrueshëm aktiviteteve turistike ngre pikëpyetje për atë se çfarë mund t'i ofrojë qyteti vizitorit përtej qendrës, restoranteve dhe jetës së natës. Një destinacion turistik si Shqipëria, që po konsolidohet vit pas viti, nuk konkurron vetëm me bukuritë natyrore.

"Çfarë mund të bëjë një turist më shumë se dy ditë në vendin tonë? Në Tiranë mjafton një ditë të shohë dy-tre pika turistike, më pas ikën drejt zonave malore apo bregdetare. Por ky lloj turisti që vjen për dy net më

5 "Arrest shtepie" për Viora Hysenli, Rama: Masë ekstreme! Akuzat të...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

shumë na shton kostot. Një turist konsiderohet i "mirë" nëse qëndron më shumë se tre net në hotel. Me pak fjalë, turisti vjen dhe argëton veten, ne nuk kemi çfarë t'i ofrojmë dhe kjo situatë mbetet një tjetër sfidë e sezonit" – pohoi Arta Sino, operatore turistike në Tiranë.

Lajm i mirë është se tashmë kemi një larmi kombësish që vijnë dhe vizitojnë Shqipërinë, ku dominojnë turistët nga Europa. Por, ndërsa sezoni 2026 po mbyllet me shifra pozitive, një tjetër faktor po krijon pasiguri për industrinë: monedha europiane. Zhvlerësimi i vazhdueshëm i euros po prek të ardhurat e operatorëve turistikë që punojnë me klientelë të huaj. Për një industri që planifikon sezonin e ardhshëm muaj përpara, kursi i këmbimit është bërë një faktor që nuk mund të injorohet.

"Jemi në një pikë që nuk duhet ta anashkalojmë zhvlerësimin e euros. Sot po mbyllim kontrata për 2027 me një euro që është 91-92 lekë, po vitin tjetër kush na garanton se monedha europiane nuk do të ulet më tej? Ky zhvlerësim ndikon direkt në humbjet e fitimeve të biznesit. Për rrjedhojë, hyjmë në një cikël vicioz që, duke e parë në pesë vitet e fundit, është një humbje e konsiderueshme për bizneset" – thotë Xhimi Lamaj.

2026 mund të ketë qenë një tjetër vit rritjeje për turizmin. Por për operatorët, sfida e vërtetë tashmë është 2027. Sepse, pas një sezoni të mirë, industria nuk kërkon vetëm më shumë turistë. Kërkon më shumë siguri, më shumë infrastrukturë, çmime më konkurruese dhe një model turizmi që mund të qëndrojë në këmbë edhe kur avantazhi i çmimeve dhe kursit të këmbimit fillon të zbehet.

/vizionplus.tv

#E-zone

#Turizmi



WRITTEN BY
Redaksia Web
Gazetar/e · Vizion Plus

Të gjithë artikujt →

Më shumë video



VIDEO

Koncerti i Kanye West, ministri Gonxhja:...

Ana Miha · 27 Sht 20:41



VIDEO

Qershor-gusht, 8.3 milionë turistë, 3% ...

Hamit Yzeiraj · 25 Sht 14:48



VIDEO

Programi i strehimit brenda vitit, katër ...

Mimoza Ibro · 24 Sht 15:27

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.